

# Maqedonia e mbetur prapa në shfrytëzimin e efektshëm të fondeve të BE-së (IPA, Programet Kornizë) – Analizë nga Analytica



## Hyrje

Progresi lidhur me Kapitullin 22 të *acquis communautaire* që ka të bëjë me politikat rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore, është vendimtare për kandidatët dhe për kandidatët potencial për të përfituar në çështjet evropiane. BE tashmë dekada të tëra ofron lloje të ndryshme të fondeve të për të ndihmuar në rajonet që kanë mbetur prapa në modernizimin dhe zhvillimin e tyre. Në mënyrë që të marrin një avantazh të plotë të përfitimeve që IPA dhe më tutje Fondet Strukturore ofrojnë, vendet do të duhet të vazhdojnë me reformat dhe kështu të krijojnë sistem funksional institucional dhe legjislativ si dhe kapacitete administrativ të përshtatshme që do të jenë në gjendje për të menaxhuar me sukses këto fonde.

Përveç IPA fondeve dhe Fondeve Strukturore, ekzistojnë gjithashtu mundësi të tjera fondesh të BE-së siç është Program korniza për kërkime dhe inovacione, i hapur për organizatat kërkimore dhe NVM-të nga e tërë bota. Ideja kryesore e BE-së lidhur me këtë është se "në një ekonomi të hapur globale, konkurrenca qëndron në kapacitetin e bizneseve për të krijuar vlerë sa më të lartë të mallrave dhe shërbimeve. Lëvizja drejt rritjes së qëndrueshme bazuar në inovacion për këtë arsye qëndron në zemër të përgjigjes së BE-së ndaj globalizimit."

Si një shtet anëtar kandidat që vetëm pak më parë mori rekomandim për fillimin e negociatave për anëtarësimin e plotë në BE, Maqedonia tashmë duhet të jetë e njohur me fondet e BE-së. Megjithatë kjo nuk është kështu. Arsyet për këtë janë qëllimi i hartimit të këtij raporti. Në këtë aspekt, raporti do të paraqesë fondet e BE-së në dispozicion për Maqedoninë dhe përfituesit potencial. Për më tepër, ky raport do të përpiqet që t'i përgjigjet pyetjes se cila është lidhja që mungon ndërmjet institucioneve dhe organizatave të cilat kanë të drejtë të aplikojnë për fonde dhe për t'i fituar ato, gjë që u dëshmuar si problem kryesor gjatë procesit të aplikimit. Sa për krahasim, do të shqyrtohen shembuj pozitiv nga Kroacia me çka do të tentohet të gjenden zgjidhje të mundshme për rastin e Maqedonisë. Në fund, do të paraqiten rekomandimet e Analytica-s, që nuk do të shërbejnë vetëm për dhënie solucion autoriteteve, por edhe si një udhëzues praktik nëpërmjet mënyrave të aplikimit dedikuar të gjitha organizatave të interesuara të shoqërisë civile.

Hyrje në Fondet e BE-së (çfarë është IPA, çka paraqesin Programet Hulumtuese Kornizë, dhe cilët janë përfitues të mundshëm të këtyre fondeve në Maqedoni)

### 1.1 Instrumenti i Para-Aderimit (IPA).

IPA është krijuar me Rregulloren e Këshillit (KE) 1085/2006 të 17 korrikut 2006 ndërsa zbatimi i tij në dispozitat e Rregullores së Komisionit (KE) 718/2007. Ky instrument vendosi nën ombrellën e tij të fondet e mëparshme në dispozicion për vendet e para-pranimit si: PHARE, ISPA, SAPARD, CARDS. Ky ka për qëllim që të pasqyrojë Fondet Strukturore të BE dhe për të ndihmuar vendet që janë në rrugë për t'u integruar në BE që të mësojnë se si të menaxhojnë më to. Kjo është bërë në mënyrë që të fitojnë përvojë për pjesëmarrje të suksesshme në Politikën e Kohëzimit dhe për absorbimin e suksesshëm të fondeve gjatë anëtarësimit në BE. IPA ka disa komponentë:

I. Asistenca e Tranzicionit dhe Ngritja e Institucioneve;

II. Bashkëpunimi ndër-rajonal (me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet të tjera të pranueshme për IPA);

III. Zhvillimin Rajonal (duke siguruar mbështetje për transportin, infrastrukturën e mjedisit si dhe përmirësimin e konkurrencës dhe reduktimin e pabarazive rajonale);

IV. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore (forcimi i kapitalit njerëzor dhe luftimin e përjashtimit);

V. Zhvillimit Rural (lloji i masave të zhvillimit rural).

Përbërësit I dhe II janë të hapur për të gjitha vendet përfituese ndërsa Përbërësit III, IV dhe V janë të hapura vetëm për vendet kandidate ( Kroacia, Turqia dhe Maqedonia). Fondet për vendet e Ballkanit perëndimor dhe për Turqinë janë hapur në vitin 2007. Përfituesit mund të jenë njësitë e administratës publike, NVM-të, institucionet e qeverisjes vendore ose subjektet tjera. Pjesëmarrja e tyre varet kryesisht nga qëllimi dhe lloji i thirrjeve për programin operativ dhe për komponentën.

Gjëja më e rëndësishme për të mbajtur mend është se të gjitha aktivitetet zhvillohen drejtpërsëdrejti me organet e Qeverisë (ministritë, agjencitë) pasi që ata janë një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet IPA fondeve dhe përfituesve të fundit.

Kur është fjala për Maqedoninë, buxheti i përgjithshëm për periudhën 2007-2013 është 622.5 milionë euro. Programi i vetëm operativ që funksionon për momentin është ai i Zhvillimit Rajonal, ku përfshihen edhe sektori i transportit dhe mjedisit në vend që ato të jenë të ndara në programe të ndryshme operative. Raporti shumë - vjetor financiar indikativ për periudhën 2007-2009 është:

Komponenta	2007	2008	2009	Total
I – Ndwrtimi Institucional	41.6	39.9	38.1	119.6
II–Bashkwpunimi ndwr-kufitar	4.2	5.3	5.6	15.1
III – Zhvillimi Rajona	7.4	12.3	20.8	40.5
IV –Zhvillimi i Burimeve Njerzore	3.2	6.0	7.1	16.3
V–Zhvillimi Rural	2.1	6.7	10.2	19
Total	58.5	70.2	81.8	210.5

Deri në këtë vit, zbatimi i IPA ishte i centralizuar që nënkuptonte se të gjitha fondet realizoheshin nëpërmejt Misionit të Delegacionit të Komisionit Evropian. Duke filluar nga korriku dhe tetori i vitit 2009, vendi fitoi akreditim nga BE-ja për të aplikuar implementim të decentralizuar të asistencës për komponentët III dhe IV. Gjithashtu është krijuar një sektor i ri që "ka përgjegjësinë e vetme për të gjitha tenderimet, kontraktimrt dhe aktivitetet e pagesës në lidhje me projektet e financuara nën IPA të Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë. Ai quhet



Departamenti qendror financiar dhe kontraktues nën Ministrinë e Financave dhe është përgjegjës për zbatim të procedurave tenderuese sipas rregullave të KE, kontraktimin e marrëveshjeve me bartësit e projekteve, kryerjen e pagesave; si dhe kontabilitetin dhe mbikëqyrjen e implementimit të përgjithshëm të projekteve. Megjithatë, ky nuk është institucioni i vetëm që publikon shpalljen e tenderëve. Për shembull Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është përgjegjëse për zhvillim të burimeve njerëzore, ndërsa disa thirrje për

bashkëpunim ndër-kufitare publikohen në ëeb faqen e Ministrisë së pushtetit lokal.

## 1.2 Kornizë programi i 7-të për Kërkim, Zhvillim Teknologjik dhe Demonstrim të aktivitetete (FP7)

Siç u përmend në hyrje, përveç fondeve IPA, Maqedonia mund të aplikojë edhe për fonde tjera të komunitetit siç janë FP7 dhe CIP. Kjo pjesë do të japë informacion të shkurtër mbi atë se çfarë është saktësisht qëllimi i tyre.

FP7 është program i veçantë për projekte kërkimore. Ky program ka një buxhet prej mbi 50 miliard euro dhe është




krijuar për periudhën 2007-2013. Përmes tij sigurohen fonde për kofinansim të hulumtimeve, zhvillimit teknologjik dhe projekte demonstruese bazuar në thirrje konkurruese dhe rishikim të pavarur të projekt propozimeve. Ekzistojnë katër blloqe kryesore nën të cilët realizohen thirrjet për propozime dhe atë: Bashkëpunimi - mes industrisë dhe akademisë, Ideja-përkrah vetëm kërkime bazë, Njerëz -- përkrah zhvillimin e karrierës dhe lëvizshmërinë e hulumtimit dhe Kapacitetet - zhvillon kapacitetet e Evropës për të bërë atë një shoqëri të bazuar në njohuri dhe dituri. Ekzistojnë gjashtë skema të mundshme të financimit: Projekte bashkëpunimi, Rrjetet e Përsosmërisë,

koordinimi dhe veprimet ndihmëse, projekte individuale, mbështetje për trajnim dhe zhvillim të karrierës së hulumtuesve. Shumica e projekteve janë dhënë në konzorciume të përbërë nga disa partnerë nga BE dhe nga e tërë bota. Ideja kryesore qëndron në mundësinë e krijimit të rrjeteve për bashkëpunim, shkëmbimi i ideve dhe njohurive në kërkime që do të ndihmojë Evropës të shëndërrohet në një shoqëri të bazuar në njohuri dhe dituri.

## 1.3 Programi kornizë për konkurrencë dhe inovacione

CIP paraqet program për qëllime të inovacionit dhe rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve evropiane dhe NVM-ve. "Programi mbështet aktivitetet inovative (duke përfshirë edhe eko-inovacione), ofron qasje më të mirë në financa dhe ofron shërbime përkrahëse të biznesit në rajon. Ai inkurajon një përdorim më të mirë të informacionit dhe teknologjive të komunikimit (TIK) dhe ndihmon në zhvillimin e shoqërisë informative. Ajo gjithashtu nxit



përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe efikasitetin e energjisë. Buxheti i përgjithshëm arrin deri në 3621 milionë euro dhe njëjtë si programet tjera operon prej vitit 2007 deri më 2013. CIP ka tre komponente kryesore: programi për ndërmarrësi dhe inovacion, e cila është më e përqëndruar në zhvillimin e NVM-ve, frymën e sipërmarrësisë dhe produkte të reja inovative; Programi për mbështetje të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICTPSP) ka për fokus bazë zhvillimin e sektorit të TIK dhe Inteligjenca Energjetike e Evropës (IEE) e cila është për gjetjen e zgjidhjeve të reja të qëndrueshme energjetike.

Maqedonia si një shtet kandidat për anëtarësim është në grupin e vendeve me të drejtë për aplikim në CIP. Kohët e fundit Qeveria e ka paguar hyrjen për në këtë Program i cili u jep te drejtën ndërmarrjeve të Maqedonisë dhe sidomos NVM-ve mundësinë të aplikojnë për fonde me projekt-identet e tyre.

Personi kontaktues nacional për Maqedoninë është Ministria e Ekonomisë. "Kjo biletë hyrje është siguruar përmes mbështetjes nga buxheti i IPA. Memorandumi i bashkëpunimit është nënshkruar vetëm për programin e sipërmarrësi dhe konkurrencë, ndërsa në rrjedhë janë bisedimet për programet e teknologjive e informimit dhe komunikimit si dhe për Inteligjenca Energjetike të Evropës. Ministria e ekonomisë gjithashtu planifikon aktivitetet promotive për për të rritur njohuritë mbi këtë program përmes konferencave të ndryshme, ëëbfaqes së ministrisë, evente publike, seminare TAIEH etj. Sidoqoftë, deri më tani organizime të këtylla për promovim të CIP në Maqedoni nuk janë hasur dhe NVM-të janë shumë pak të informuara për mundësitë e finansimit që ekzistojnë në UE.

2. Cila është hallka që mungon ndërmjet aplikimit të organizatave dhe ndërmarrjeve që janë të kualifikuara për fonde dhe fitimi real i atyre fondeve?

2.1 Sa efektive është mënyra e shfrytëzimit të IPA në Maqedoni?

Kur flasim për efektivitetin e IPA, me rëndësi është të dihet se nën çfarë kriteriumesh matet sukcesi i shfrytëzimit të këtij instrumenti. A ka të bëjë me numrin e kontratave të nënshkruara brenda një viti? Ose ka të bëjë me numrin e saktë të mjeteve të shfrytëzuara brenda një viti: Ose ndoshta edhe me numrin e projekteve të përfunduar me sukses? Nuk do të mund të flasim për realizim të suksesshëm të IPA programeve nëse shohim vetëm se a janë mjetet finansiare të projektuara për vitin një vit të caktuar të edhe të realizuara. Në vend të kësaj, do të fitohet një pasqyrë më e qartë nëse merret parasysh sa prej fondeve janë të realizuara në projekte që nga momenti i nënshkrimit të kontratave finansiare. Maqedonia e fitoi akreditimin për menaxhim të decentralizuar me IPA komponentet III dhe IV në qershor dhe shtator të vitit 2009. Akreditimi për komponentet I dhe II pritet të fitohet në pranverën e vitit 2010. Kjo është e një rëndësie të madhe pasi që tash e tutje qeveria dhe ministrinë do të jenë plotësisht përgjegjëse për shpallje të tenderëve dhe implementimin e tyre të drejtë. Ky zhvillim i ngjarjeve shkaktoi një frikë dhe dyshim të konsiderueshëm rreth mundësisë së dështimit për menaxhim të mjeteve si pasojë e dobësive tashmë të njohura të administratës së Maqedonisë si dhe korupcionit dhe partizimit ende prezent në të gjitha portet e shoqërisë. Pasi që akreditimet janë fituar vetëm pak kohë më parë, mbetet të shihet se në cilin drejtim do të zhvillohen ngjarjet dhe nëse ky dyshim dhe frikë janë të arsyeshëm.

Për sa u përket fondeve të projektuara për vitin 2007, supozohet se rreth 80% e tyre janë të kontraktuara me shtetin. Megjithatë, kur bëhet fjalë se sa prej tyre janë të shëndrruar në projekte situata duket më ndryshe. Sipas Qendrës maqedonase për arsim evropian “vetëm disa projekte të komponentës I janë tashmë në fazë të implementimit, dhe atë: mbështetje për implementimin e reformave në polici (9 milion euro), mbështetje infrastrukturës lokale dhe kohezionit social dhe ekonomik (7 milion euro), mbështetje Entit të statistikës (2 milionë euro), mbështetje implementimit të reformës në administratën publike (2 milion euro), Masa përgaditore për mësim të përgjithshëm dhe programe për të rinj (0,9 milionë euro), pjesëmarrje në programet e bashkësisë dhe agjensioneve (0,95 milionë euro) si dhe trajnime për përgaditje të projekteve, auditim dhe evaluim (3 milionë euro).

Nga të gjitha mjetet e parapara për vitin 2007, që arrijne deri në 58.5 milion euro, vetëm 42% janë realisht të shfrytëzuara dhe the alokuara në projekte konkrete. Jozyrtarisht shkaku i shfrytëzimit të dobët të mjeteve të 2007 është kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve të Maqedonisë për t’u ballafaquar me këto obligime. Pyetje tjetër e rëndësishme është vendosja e prioritetëve nga ana e qeverisë kur është hartuar planifikimi indikativ para 2007. Rezultati i fundit ishte vetëm një program operativ – ajo e Zhvillimit rajonal për ndërtim të kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturore të shtetit. Për dallim nga Kroacia dhe Turqia, në Maqedoni ende ekziston ndjenja se kapacitetet jo vetëm të administratës por edhe të sektorit ekonomik nuk janë në nivel të lartë që të mund të aplikojnë lirshëm dhe të implementojnë me sukses projektet e fituara. Mu për këtë, për periudhën e projektuar 2007/2013, komponenti Konkurrenca rajonale është i lënë anash dhe mbetet si sfidë për autoritetet që t’a përfshijnë në periudhën 2013/2016.

Nga kjo vjen ndjenja se krahasuar me Kroacinë dhe Turqinë, Maqedonia është më e dobët, mbetet prapa me shfrytëzimin e IPA. Kapaciteti i dobët institucional, eksperiencia e pamjaftueshme e sektorit privat me fonde të këtilla dhe mospasja e trajnimeve adekuate për ta, janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë në krijimin e një situatë të këfillë me fondet e UE-së në Maqedoni. Këto çështje të hapura së bashku me disa të tjera do të diskutohen dhe analizohen në kapitullin e ardhshëm të këtij raporti.

## 2.2. Hallka që mungon për shfrytëzim efektiv të Fondeve të UE-së

1. Ekziston konfuzion rreth asaj se cka saktësisht bëhet nëpër ministri dhe sektorë dhe nën ç’udheheqje kur bëhet fjalë për Fondet IPA. Lidhur me këtë, përpjekjet e autoriteteve për të sqaruar tërë këtë situatë janë të pamjaftueshme. “Deri më tani, qeveria ka shtypur vetëm tre broshura me font 8 që është vështirë për t’i lexuar, dhe gjuha me të cilën është shkruar nuk është e kuptueshme për cdokend. Ka mungesë të informata të rëndësishme për programet e komunitetit, sic janë emrat e personave përgjegjës nëpër ministri... Mospasja qasje në nëpunësit e SCE vecme u diskutua në raportin e kaluar të Analitikës dhe kjo situatë për fat të keq vazhdon të jetë e njejtë.

Ajo që është edhe më shumë brengosëse është fakti se edhe ministrinë tjera dhe departamentet përgjegjëse të tyre për menaxhim me IPA dhe programet tjera të UE-së janë gjithashtu të paarrtshëm dhe pa vullnet për të bashkëpunuar dhe ndarë çfarëdo lloj informate për menaxhim me fondet.

2. Problem tjetër aktual është planifikimi i pakoordinuar i procesit programues dhe realizimit të tij. Sekretariati për çështje evropiane është përgjegjës për këtë çështje, megjithatë planifikimi i zhvilluar deri më tash nuk është as strategjik as i koordinuar. Procedura e brendshme është si vijon: “SCE ua dergon të gjitha ministrive, agjencioneve dhe institucioneve publike planin financiar që është i specifikuar me Planin shumevjeçar indikativ dhe kërkon prej tyre të zhvillojnë projekt propozime që llogariten si prioritare. Pas një periudhe të caktuar të gjithë propozimet kthehen prap dhe zgjidhen ato që janë të realizueshme dhe të përpiluara mirë deri në shumën e paraparë. Kjo dëshmon se qeveria nuk ka politikë koherente dhe se mënyra e kësaj nuk tregon se ku saktë nevojiten mjete pasiqë ne disa ministri ka mungesë kuadrosh që nuk dinë të shkruajnë projekt të mirë e në anën tjetër nevoja për investime është e madhe.

3. Pengesë kryesore është edhe mungesa e dokumenteve strategjike. Plani kombëtar për zhvillim 2008-2010 nuk është i kualitetit të lartë. Gjithashtu, nuk ka kurfarë strategjie për atë se çfarë projektesh janë të rëndësishme esenciale për periudhën 2007/2013 dhe gjithashtu besohet se as autoritetet nuk e dinë se cka saktë duhet të vendoset si prioritet për këtë periudhë.

4. Involvmi i OJQ-ve në promovimin e IPA. Konsultimet me OJQ-të mund që të ndihmojnë në kapërcimin e problemeve të përmendura më parë dhe në hartimin e planeve strategjike, pasi që ata janë të njoftuara me situatën në terren. Megjithatë një praksë e tillë nuk ekziston këtu. Pikë së pari, mungojnë të dhëna statistikore rreth asaj se sa nga OJQ-të janë kualifikuar për projekte IPA dhe për programet tjera të komuniteteve dhe sa prej tyre procentualisht rregullisht aplikojnë për grante. Domethënë nuk mund që të vërtetohet sa është njohuria e procesit të aplikimit për fondet e UE-së nëpër OJQ-të e Maqedonisë. Së dyti, për procesin e konsultimeve gjatë përpilimit të strategjisë indikative shumëvjeçare nga e cila varet se për çfarë projektesh Maqedonia do të mund të aplikojë përmes IPA, vetëm një nga 6000 OJQ të regjistruara është ftuar të marrë pjesë. Gjithashtu, edhe pse janë paralajmëruar takime konsultative, ata shumicën e kohës janë të caktuara në kohë të papërshtatshme (gjatë pushimeve ose nuk jepet kohë e mjaftueshme për përgaditje ndërmjet kohës së caktimit të takimit dhe mbajtjes së tij) ose mbahen kur vecmë qeveria ka vendosur se çfarë projektesh do të mund të aplikohet me cka komentet dhe këshillat e OJQ-ve ngelin të pashfrytëzuara. Kur këtyre problemeve u shtohet kapaciteti i dobët i administratës, bëhet e qartë se kapaciteti i përgjithshëm i sistemit për shfrytëzim efektiv të fondeve të UE-së nuk është aspak në nivel të kënaqshëm. Këtu gjithashtu duhet të ceket edhe mungesa e iniciativave në Komision për promovim më agresiv të programeve të tij në Maqedoni si dhe organizimi i dobët i sektorit joqeveritar rreth kësaj çështjeje, që gjithashtu kontribuojnë në shfrytëzimin e dobët të këtyre fondeve.

3. Rekomandimet e Analitika-s për shfrytëzim më efikas të fondeve të UE-së.

### 3.1 Përvoja pozitive – rasti I Kroacisë

Përvoja pozitive e Kroacisë mund që t'i ndihmojë shumë Maqedonisë në menaxhimin e IPA Fondeve. Që në shikim të parë vërrehet se institucionet kroate që menaxhojnë me fondet e UE-së janë transparente dhe të konsoliduara mirë. Ekziston Zyrë qendrore për strategji zhvillimore dhe koordinuese të EU fondeve e cila kryen detyra ekspertive dhe administrative që janë të lidhura me përgaditjen e Strategjisë zhvillimore të Kroacisë...dhe është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të fondeve të UE-së. Të gjitha programet e Bashkësisë janë detalisht të sqaruara, më tej Zyra i shpall tenderët për projekte si dhe të gjitha kontaktet e nevojshme. Përveç kësaj, në faqen e internetit janë të publikuara të gjitha dokumentet strategjike të Kroacisë, të shkruara detalisht, në anglisht dhe me qasje për publikun.

Sa për ilustrim: Programi operacional për transport për vitin 2007-2009 është 120 faqe i gjatë, në gjuhën angleze, me SËOT dhe analizë socio-ekonomike të kompletuar për sektorin e transportit në Kroaci, e kompletuar me prioritetet strategjike dhe strategjitë programore për atë periudhë si dhe me të gjitha çështjet që ndërlidhen me finansimin e këtij programi operacional. E njëjta strategji është e aplikueshme edhe për Programet operationale të ambientit jetësor, zhvillim të burimeve njerëzore, zhvillim të bujqësisë dhe planit për zhvillim rural për periudhën 2007-2013, IPARD programin si dhe programet për bashkëpunim ndërkufitar. Kjo zyrë kroate gjithashtu është e hapur për të dhënë informata të çfarëdo lloji karakteri, gjë që vetëm e vërteton profesionalizmin e saj në dhënie të shërbimeve.

### 3.2 Rekomandime për autoritetet e Maqedonisë.

Rekomandimi 1: Menaxhim i koordinuar dhe i thjeshtësuar i fondeve të UE-së.

Formimi ose autorizimi i njërit nga agjencioneve ose zyrave për koordinim të fondeve të UE-së është i një rëndësie esenciale për të gjithë ata që duan thelbësisht të informohen për mënyrat e finansimit. Kështu ata do të dinë saktë

ku të drejtohen për të marrë informatat e nevojshme. Puna e hapur dhe transparente me dokumentacion strategjik është thelbësore nëse Maqedonia dëshiron të shoh dobi nga fondet. Kontakt informacionet e personave që janë përgjegjës për menaxhimin me to dhe që posedojnë të gjitha informacionet për procedurat e aplikimit për grante duhet patjetër të jenë të publikuara në faqet e internetit të ministrive dhe zyrave përgjegjëse, që të gjithë ata që janë të interesuar të dinë ku të drejtohen.

Rekomandimi 2: Zhvillimi i instrumentit për përhapje dhe informim.

Mënyra e promovimit të fondeve nga ana e qeverisë është gjithashtu e lidhur ngushtë me rekomandimin e parë. Përveç disponimit me kontakte të besueshme në dispozicion të publikut, e rëndësishme është që të organizohen edhe kampanja publike për afirmim të tyre. Broshura të shtypura që janë lehtë për t'u kuptuar, shpërndarja e tyre nëpër tërë vendin, organizim i ditëve të informimit, përfshirja e OJQ-ve në këto aktivitete dhe formimi i IPA forumit interaktiv qoftë në internet faqen e Sekretariatit për çështje evropiane, qoftë të CFCD për shkëmbim të ideve dhe ku do të mund të parashtrihen pyetje lidhur me fondet, janë vetëm disa nga mekanizmat për rritje të ndërgjegjes së shoqërisë për mundësitë e finansimit që ekzistojnë me IPA dhe Programet e komunitetit.

Rekomandimi 3: Konsultime të vazhdueshme gjatë përgaditjes së dokumenteve strategjike si MIPD me Misionin e KE dhe sektorin joqeveritar dhe privat në RM

Njëra nga çështjet më kryesore në menaxhimin e suksesshëm me Fondet e UE-së është pa dyshim bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve të involvuara. Në njërin anë qëndron misioni i UE-së e përgjegjshmë për "paratë", në tjetrën Qeveria e cila menaxhon dhe koordinon mjetet dhe si palë e tretë janë shfrytëzuesit e fundit si OJQ-të dhe subjekte tjera. Të gjitha palët duhet të punojnë së bashku gjatë përpilimit të dokumenteve nacionale strategjike si dhe të strategjisë shumëvjeçare indikative (MIPD). Qeveria duhet të mundësojë qasje në të gjitha dokumentet e rëndësishme gjatë rrjedhës së konsultimeve. KE duhet të kërkojë nga Qeveria të publikojë planet konsultative për tema të ndryshme që dalin nga IPA më së paku 1 vit para, me cka të gjitha palët do të kenë kohë të mjaftueshme për tu përgaditur. „Konsultimet duhet të jenë të shoqëruara me plan për ndërtim të kapaciteteve që fillimisht mund të ketë formën e mbledhjeve para-konsultative në të cilat pjesëmarrësit do të mësojnë së cka pritet prej tyre në kontekst të IPA procedurave programore komplekse.

Rekomandimi 4: Edukimi.

Edukimi joformal për mundësitë e finansimit të UE-së është parakusht për pasjen e aplikacioneve të suksesshme dhe projekteve të fituara. Përvoja pozitive e Kroacisë i thekson përfitimet e procesit edukativ për rritje të diturisë në lidhje me skemat e finansimit të UE-së.

„Edukimi i të gjitha palëve të interesuara, posacërisht të shfrytëzuesve potencial, ka ndikim parësor në rritjen e fondeve të alokuara brenda cdo viti. Procesi edukativ implementohet përmes mbajtjes së seminareve dhe punëtorive të ndryshme. Promovimi dhe informimi i publikut të gjerë përmes mediave për projektet e finansuara përmes fondeve të UE-së arriti që të rrisë interesimin për aplikim me propozim-projekte të llojllojshme.

3.3 Rekomandime për sektorin joqeveritar dhe atë privat në Maqedoni.

Si të përgaditet aplikacion i suksesshëm?

Për sa i përket sektorit privat, OJQ-ve si dhe organizatat tjera hulumtuese që duan të aplikojnë me projekte vetanake përmes programeve tjera të Programeve të komunitetit (FP7 ose CIP), Analitika së bashku me një menaxher të suksesshëm hartuan listë të elementeve të nevojshme për përgaditje të aplikacioneve të suksesshme. Përgaditje e propozim-projektit për Fondet e UE-së:

#### 1. Koncepti i projektit

a. A është ideja në përputhshmëri me shpalljen për projekt?

b. A është ideja relevante dhe a ka nevojë për kontekst gjeografik( pjesëmarrësit e targetuar) dhe në kontekst të shpalljes për projekte (si psh. Tema, qëllimet e KE, inovacionet shkencore)?

c. Me rëndësi është të vendoset vëmendje e vacantë ne tekstin e shpalljes për projekte

– esenca e propozimit duhet t'i përmbajë të gjitha elementet të cilat kërkohen nga KE

- d. Propozim projekti duhet të jetë ambicioz pa qenë i pakuptueshëm dhe i perealizueshëm.

## 2. Konzorciumi i projektit

- a. Konzorciumi i fuqishëm që do t'i japë fuqi dhe përparësi propozimit
- b. Duhet të ketë numër të balansuar të pjesëmarrësve - konzorciumet e mëdha janë rëndë për tu udhëhequr, derisa të vegjëlit ndoshta nuk posedojnë eksperiencë të mjaftueshme për të implementuar projektin
- c. Të gjithë partnerët duhet të kenë rolet e identifikuar në projekt dhe të jenë tërësisht të kycur në përgaditjen e projektit.
- d. A Koordinator i fuqishëm i projektit me eksperiencë të mjaftueshme është i një rëndësie vitale.

## 3. Përmbajtja e propozimit

- a. Përgjigjuni përmbajtjes së tekstit në shpallje dhe direktivave të dhëna në të.
- b. Spjegoni sa më qartë qëllimet e juaja, rezultatet e pritshme dhe planin e punës, me cka gjithashtu do të spjegoni edhe esencën e konceptit (shkencë, teknologji zhvillimore).
- c. Demonstrojeni qartë fuqinë e konzorciumit dhe arsyen pse secili partner është zgjedhur të marrë pjesë në të. Demonstroni që konzorciumi ka kohezion dhe strukturë të qartë menaxheriale
- d. Nuk duhet assesi të fshini ose të përshkruani, kujdesuni që struktura të jetë koncize dhe mendimet të kenë rrjedhë (kalim i qartë nga koncepti deri te qëllimet)

## 4. Buxheti

- a. Edhe propozim-projekti brilant mund të mos kalojë nëse ka propozim-buxhet tej ambicioz.
- b. Mbajeni buxhetin në linjë me aktivitetet e pritshme dhe resurset
- c. Planifikojeni buxhetin në fazë sa më të hershme, në ndërkohë duke u siguruar që resurset e cdo partneri individual janë të barabarta me punën në projekt dhe resurset e alokuara.
- d. Shqyrtoni detajisht direktivat finansiare (shumë e rëndësishme). Shumica e projekteve kërkojnë kontribut vetanak nga kompanitë. Sigurohuni që partnerët janë të vetëdijshëm për këtë gjë, me qëllim që të mund të marrin pjesë ekonomikisht në



projekt dhe që të evitohen konfliktet që në fillim të projektit.

## 5. Konkluzat tjera

- a. Shpërndarja dhe ruajtja e të drejtave intelektuale duhet patjetër të adresohen në projekt. Tregoni qartë mënyrën se si projekti do të shpërndahet ndërmjet audiencës së gjerë (përmes afarë metodash), dhe cili do jetë fati i rezultateve konkrete që do të dalin nga projekti. Strategji e qartë IPR mund të ndihmojë në shfrytëzimin e mëtutjeshëm të rezultateve të projektit (psh. Lloj i ri softveri, produkt i ri, material për trajnim etj.)
- b. Demonstrimi i suksesit nga projektet tjera mund gjithashtu të përforcojë propozim-projektin. Ndiqni direktivat që kanë të bëjnë me përshkrimin e partnerëve dhe aktivitetet lidhur me to.
- c. Filloni sa më herët! Mund t'ju duhen 3 deri 6 muaj për të përfunduar tërë projektin, duke pasur parasysh që përgaditjet për propozim projektet fillestare mund të zgjasin 2-3 muaj. Puna esenciale lidhur me temën e projektit, sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm (tani e zëvendësuar me dërgim elektronik të projektit), elaborimi i buxhetit dhe finalizimi i projektit janë punë që marrin mjaftë kohë dhe duhet të jenë të planifikuara paraprakisht.

## Vërrejtje përfundimtare

Me afrimin e Maqedonisë drejt UE-së, automatikisht rriten skemat për finansim. IPA është vetëm një nga instrumentet e Unionit qëllimet kryesore të të cilit përfshijnë ndihmën për vendet kandidate potenciale dhe kandidate gjatë harmonizimit të legjislacionit dhe implementimit të tërësisht të *acquis communautaire*.

- Ekzistojnë edhe Programe tjera të Komunitetit në të cilat Maqedonia mund të marrë pjesë si FP7 dhe CIP. „Biletat hyrëse” janë të paguara dhe kompanitë e Maqedonisë, OJQ-të dhe individë mund të dërgojnë propozim projektet e tyre nëse gjejnë shpallje adekuate për projekte.
- Qeveria kohë më parë fitoi akreditim për menaxhim të decentralizuar me komponentët III dhe IV të IPA, ndërsa për komponentët I dhe II, është e paraparë të fitohet në pranverën e 2010. Të gjithë tenderët e vitit 2010 do të publikohen në internet faqen e DQKF në Ministrinë e finansave të Republikës së Maqedonisë. Megjithatë, ekzistojnë çështje të hapura lidhur me IPA Fonder dhe shfrytëzimin e Programeve tjera të komunitetit. Vetëm disa projekte të komponentës I të vitit 2007 janë implementuar deri më tani. Gjithashtu nuk ekziston strategji e qartë për dokumentet e rëndësishme strategjike për dokumentet e rëndësishme strategjike që duhet të përgaditen nga autoritetet e këtyre fondeve.
- Ekziston një qëndrim i caktuar se kapaciteti i pamjaftueshëm i administratës e zvogëlon rolin e shtetit në fondet e UE. Gjithashtu komunikimi me sektorët tjerë të shoqërisë lidhur me këtë çështje është në nivel shqetësues.
- Masat si: shpërndarje më e mirë e informatave, broshura kualitative, qasje deri personat përgjegjës për menaxhim me fondet, internet faqe të qarta dhe të koordinuara, azhurnim i vazhdueshëm me të gjitha informacionet e nevojshme dhe shpalljet më të reja për projekte, trajnime dhe programe edukative për procedurat e IPA dhe Programeve tjera të komunitetit mund Maqedonisë t'i ndihmojnë të rrisë kapacitetin e shfrytëzimit dhe menaxhimit të EU fondeve.
- Konkluzioni përfundimtar i kësaj analize do të ishte që Maqedonia me të vërtetë ngelet mbrapa në shfrytëzimin efektiv të IPA dhe fondeve tjera të UE-së. Arsytet për këtë janë nga më të ndryshmet dhe pasqyrojnë kapacitetin e dobët administrativ dhe mungesën e strategjive kualitative. Masat e propozuara mund të ndihmojnë në ndëryshimin e gjendjes në Maqedoni.

## EU Approximation and Integration Advocacy Program

“Macedonia e mbetur prapa në shfrytëzimin e efektshëm të fondeve të BE-së (IPA, Programet Kornizë) – Analizë nga Analytica”

Sonja Risteska, Research Fellow of the Program

[sristeska@analyticamk.org](mailto:sristeska@analyticamk.org)

### Analytica

Web: [www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

Email: [info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)

Dame Gruev No: 7-8/3

1000 Skopje, Macedonia

Phone: 00 389 (0)2 3121 948

Fax: 00 389 (0)2 3121 948